



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 59.
Prishtinë, më 25.01.2013 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Rasim Demiri.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB, Elita Vokshi, Lejla Selimi, Erxhan Galushi, përfaqësuese i Sekretariatit të KKK Zijush Ahmeti, përfaqësues të zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tisma, zyrtarë e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu, praktikant Eldin Buzgovic.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Draft- Planit dhe programit të punës për vitin 2013;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil me Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerjen e FSK-së.;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor me Raportin me amendamente të komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Draft- Planit dhe programit të punës për vitin 2013;

Kryesuesi – tha se komisioni në mbledhjen e kaluar ka emëruar grupin punues për hartimin e Draft –Planit të punës për vitin 2013. Një falënderim i veçantë i takon organizatës së OSBE-së dhe institucionet tjera ndërkombëtare siç janë: Ambasada Zvicerane, ICO, NDI, Ambasada Amerikane.

Lidhur me përgatitjen e draft-Planit të punës, fjalën ia dha Lumnije Morinës.

Lumnije Morina- theksoi se në bashkëpunim të mirëfilltë me anëtarët e grupit punues është arritur hartimi i planit të punës për vitin 2013, ku dhe janë inkorporuar të gjitha propozimet tona.

Ajo ishte falënderuese për bashkëpunim korrekt me përfaqësuesen e OSB-së z. Elita Vokshi, përfaqësuesen nga Ambasada Zvicerane znj. Sakibe Jashari dhe stafin mbështetës të komisionit. Diskutoi lidhur me organizimin e takimit dy ditore i cili do të mbahet në një qytet të Kosovës, projekt ky i mbështetur nga OSBE-ja, në krye me përfaqësuesen znj. Elita Vokshi. Ishte e mendimit që Komisioni në një periudhë sa më të afërt të caktojë takim me Ministrin e Punëve të Brendshme. Konsideron se këto pika duhet të radhitet në planin dhe programin e punës.

Petar Miletic - pajtohet me propozimin që së pari në komision të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme Çështja e dytë e ngritur është se para fillimit të pushimit veror, të ftohet Ministri i Bujqësisë. Propozoi që në raportin përkatës të fshihet fjala institucioneve relevante dhe të zëvendësohet me fjalën komisar për gjuhët.

Albert Kinolli- në kuadër të përpilimit të draft- Planit të punës, ai falënderohet për bashkëpunim të mirë me grupin punues dhe përfaqësuesve nga OSB-ja dhe Ambasada Zvicerane.

Lidhur me draftin e punës, u ndërlihd që në periudhat e ardhshme të anashkalohen të gjitha mangësitë e lëshuara gjatë vitit 2012.

U fokusua tek mbikëqyrja e zbatimit ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, aludoi që në vitin 2013, të jetë me prioritet trajtimi adekuat, sa i përket banimeve jo formale të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

Pas diskutimeve dhe propozimeve konkrete, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri miratoi Draft- Planin dhe programin e punës për vitin 2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil me Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerjen e FSK-së.;

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr.04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor me Raportin me amendamente të komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic